


Njihni **A****B****C****D****E**-të tuaja



A Albuminuria
(Test urine)

B Presioni Arterial

C Kolesterol

D Diabeti Mellitus

E Vlerësimi i Filtrimit Glomerular
(eGFR) (Test gjaku)

Njihni **ABCDE**-të tuaja për të parandaluar sëmundjet kardiovaskulare dhe për të jetuar një jetë më të gjatë e më të shëndetshme

ABCDE- është akronim që përdoret për të përshkruar 5 parametrat kryesorë që kontribuojnë në rrezikun për sëmundje kardiovaskulare dhe të veshkave. Këta parametra korrigjohen me trajtime specifike që parandalojnë sëmundjet kardiovaskulare dhe kronike të veshkave dhe rrisin pritshmërinë për një jetë të shëndetshme.

Albuminuria (Test Urine)

Prania e albuminës në urinë tregon dëmtim të veshkave dhe shkakton humbjen e proteinës anti-plakje Klotho. Albuminuria mundëson identifikimin dhe trajtimin e sëmundjes së veshkave para se funksioni i tyre të zvogëlohet. Trajtimi bëhet me medikamente që reduktojnë albuminurinë.

A



Presioni Arterial

Presioni i lartë i gjakut është si shkak ashtu edhe pasojë e sëmundjes kronike të veshkave. Presioni i lartë i gjakut përshpejton përkeqësimin e funksionit të veshkave dhe sëmundjeve kardiovaskulare. Ajo trajtohet me medikamente që ulin presionin e gjakut.

B



Kolesterol (Ne gjak)

Nivelet e larta të kolesterolit në gjak kontribuojnë në zhvillimin e aterosklerozës, duke rritur rrezikun e mortalitetit. Ajo trajtohet me medikamente që ulin kolesterolin.

C



Diabeti Mellitus (Ne gjak)

Nivelet e larta të glukozës në gjak lejojnë diagnostikimin dhe trajtimin e pre-diabetit dhe diabetit. Pre-diabeti dhe diabeti shkaktojnë sëmundje të veshkave dhe kardiovaskulare. Ato trajtohen me medikamente që ulin nivelin e sheqerit në gjak.

D



Shkalla e Vlerësimit Të Filtrimit Glomerular (eGFR) (Test gjaku)

Nivelet e larta të kreatinës në gjak tregojnë humbjen e funksionit të veshkave. Funksioni i veshkave vlerësohet si eGFR ne baze te nivelit te kreatinines në gjak. Humbja e funksionit të veshkave nënkupton sëmundje të veshkave dhe çon në përshpejtimin e plakjes biologjike. Sëmundja e veshkave trajtohet fillimisht me medikamente që mbrojnë veshkat dhe ngadalësojnë humbjen e funksionit të tyre. Kur humbet 90% e funksionit të veshkave, është e nevojshme dializa ose transplant i për të zëvendësuar funksionin e veshkave.

E



strongkidneys@era-online.org